



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:063847
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05598383

KPPP.nr.2487/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani në çështjen përmbartimore të kreditorit Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Kosovë me seli në Prishtinë, kundër debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit për NSH “Ina Tregovina” me seli në Prishtinë, rruga Dritan Hoxha, nr.55, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.191/22 të datës 01.11.22, të Përmbartuesit Privat Driton Govori me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 19.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështjen përmbartimore me numër KPPP.nr.2487/22, të kreditorit Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Kosovë kundër debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit për NSH “Ina Tregovina” me seli në Prishtinë.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij Aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj t’i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Kosovë, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.191/22 të datës 01.11.22, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor Vendimit 01Nr.09-04-18/2022 i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të masës ndëshkimore, në afat prej 8 ditësh të paguaj shumën në vlerë prej 2,100.00€.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se Agjencia Kosovare për Privatizim (AKP) – Autoriteti i Likuidimit vepron në emër dhe për llogari të NSH “Ina Tregovina”, duke qenë se është nën menaxhimin e AKP, urdhri përmbartimorë është lëshuar në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 10.1. i cili përcakton se çdo veprim gjyqësorë dhe administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që i përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i vendimit për likuidim, pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo gjykatën e arbitrazhit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, të shfuqizohet urdhri përmbartimorë bashkë me të gjitha veprimet e ndërmarra përmbartimore.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të shkresave të lëndës vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret në cilësinë e debitorit në këtë çështje përmbartimore është Agjencia Kosovare e Privatizimit, gjykata iu referua Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili përcakton kompetencat ekskluzive të Dhomës së Posaçme, përkatësisht në paragrafin 7 të nenit 5 me të cilin përcaktohet se: *“Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 të këtij neni...”*, ndërsa me paragrafin 1 nën par. 1.5 të po të njëjtit nen përcaktohet se: *“kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me: 1.5.1. çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ;...”* gjykata gjeti se nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje juridike sepse kjo çështje bie në kompetencë ekskluzive të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2487/22, datë 19.04.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.